

PARLAMENTI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

NOCIONE KRYESORE :

Parlamenti; legjislativi; vetëshpërndarja; interpelanca; pyetjet e përfaqësuesve; imuniteti; grupet punuese të përhershëm dhe të përkohshëm; komisionet e anketave; propozimi për sjelljen e ligjit; propozuesit e autorizuar; propozimligji; projektligji; shumica absolute; shumica relative; shumica e cilësuar; vetoja; *vecatio legis*; procedura e shkurtuar për sjelljen e ligjeve; procedura e përshpejtuar për sjelljen e ligjeve.

PYETJE :

1. Sa deputet ka Kuvendi sipas Kushtetutës së R M-së ?
2. Kush mund të zgjidhet për deputet ?
3. A mund deputeti të revokohet ?
4. Në cilat raste deputetit mund t'i ndërpritet mandati para përfundimit të mandatit të Kuvendit ?
5. Për sa mandate zgjidhen deputetët ?
6. Nga cili moment fillon të ecë mandati i deputetëve ?
7. Kur dhe kush e thërret seancën konstituive të Kuvendit ?
8. Kush mund ta shpërndajë Kuvendin e RM-së ?
9. Në bazë të kompetencave ligjore, çfarë autorizimesh ka Kuvendi i RM-së ?
10. Cilët organe dhe bartës të funksioneve publike përkatësisht i emëron Kuvendi ?
11. Ç'është pyetja e deputetëve?
12. Ç' është interpelanca ?
13. Ku është dallimi ndërmjet pyetjeve të deputetëve dhe interpelanca ?
14. Ç'është amnistia ?
15. Sa deputet duhet të jenë të pranishëm që Kuvendi të mund të vendos ?
16. Çfarë lloj grupesh punuese ekzistojnë në Kuvendin e RM-së ?
17. Cili është komisioni i përhershëm anketues në Kuvendin e RM-së ?
18. Cilat janë funksionet e Kuvendit ?
19. Në çka bazohet imuniteti i deputetëve ?
20. Kush mund të ngrejë iniciativë për sjelljen e ligjit ?
21. Kush janë propozuesit e autorizuar të ligjeve ?
22. Sqaro procedurat e sjelljes së ligjeve në Kuvendin e RM-së ?
23. Ç' janë ligjet organike ?
24. Në cilat raste mund të sillen ligji sipas procedurës së përshpejtuar ?
25. Kur sillen ligji sipas procedurës së shkurtuar ?
26. Ç'është shumica e cilësuar ?
27. Ç'është shumica absolute ?
28. Ç'është shumica relative ?
29. Ç'është *vecatioe legis* ?
30. Kush e firmos dekretin për shpalljen e ligjit dhe kush mund të vendosë që mos ta firmosë të njëjtin ?
31. Ku shpallen ligjet e miratuara ?

1. Pozita, përbërja dhe mandati i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

Pushteti legjislativë në shtet, sipas parimit të ndarjes së pushtetit, është në duart e Parlamentit. Fjala parlament rrjedh nga shprehja latine *parlare*, që do të thotë të flitet. Si pas emërit të vet, parlamenti paraqet vend ku zhvillohet diskutimi, debatohet, flitet. Parlamenti si institucion paraqitet në feudalizëm si rezultat i kërkesës së feudalëve për të kufizuar të drejtën e monarkut që t'u imponojë tatime sipas dëshirës së tij. Duke filluar si një organ në të cilën është paraqitur fisnikëria, me kalimin e kohës parlamenti fiton funksionin të cilin e ka sot në vendet e botës, funksionin e trupit përfaqësues të qytetarëve.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e definojnë Kuvendin si *organ përfaqësues të qytetarëve dhe bartës të pushtetit legjislativ të Republikës*.

Si trup përfaqësues i qytetarëve, Kuvendi i RM-së zgjedhet në zgjedhjet e përgjithshme të drejtëpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Askush nuk mund ti kërkojë përgjegjësi qytetarit për shkak të votimit, as nga ai të kërkojë për të thënë se cilin e ka votuar ose pse nuk ka votuar. Qytetarët e RM-së zgjedhin prej *120 deri në 140 deputetë* në Kuvend. Sipas ligjit për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e RM-së¹, në Kuvendin e RM-së zgjedhen 120 deputetë. Të drejtën për tu zgjedhur deputet e ka çdo qytetar i RM-së i cili ka mbushur 18 vjet, ka zotësi për të vepruar dhe nuk është duke vuajtur dënim me burg për vepër penale të kryer. Deputetët në Kuvendin e RM-së përfaqësojnë qytetarët në Kuvendë, me çka vendosin sipas bindjeve personale.

Deputetët zgjedhen për një *periudhë mandatare prej katër vitesh*. Gjatë mandatit deputeti *nuk mund të revokohet*. Deputetit mund t'i ndërpritet mandati para përfundimit prej katër vitesh të mandatit të përbërjes parlamentare në qoftë se : jep *dorëheqje*; dhe në qoftë se është i *dënuar* për vepër penale për të cilën parashihet dënimi me burgim më së paku 5 vjet. Në këto raste deputetit i ndërpritet mandati sipas forcës së Kushtetutës. Deputetit *mund t'i hiqet mandati* kur është dënuar për vepër penale ose vepër tjetër të dënueshme që e bën të *padenjë* për kryerjen e funksionit të deputetit; si dhe për *mungesë* të paarsyeshme në Kuvend më shumë se gjashtë muaj. Në këto dy raste heqjen e mandatit e vërteton Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të llogaritet nga seanca konstituive e Kuvendit. Kuvendi i ri i posazgjedhur zhvillon seancën konstituive më së voni 20 ditë nga mbajtja e zgjedhjeve. Seancën konstituive e thëret kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme. Në qoftë se seanca konstituive nuk caktohet në afatin e parashikuar, deputetët takohen vetë dhe zhvillojnë seancën konstituive të Kuvendit në ditën e njëzetënjëtë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Zgjedhjet për deputetë të Kuvendit mbahen në 90 ditët e fundit nga mandati i përbërjes së vjetër parlamentare ose në afat prej 60 ditëve nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.

¹ “Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 42/2002.

Mandati i deputetëve mund të zgjatet vetëm në rast lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme.

Kuvendi shpërndahet nëse për këtë shprehet shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Do të thotë, Kuvendi vetëshpërndahet nëse për këtë vendosin shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Asnjë organ tjetër nuk ka të drejtë të shpërndajë Kuvendin e RM-së. Kjo është njëra ndër recidivet e sistemit parlamentar të bashkimit të pushtetit kur Kuvendi ishte organ qendror dhe bartës i pushtetit më të lartë në shtet. Në vendet me sistem parlamentar dhe të përzier e drejta e shefit të shtetit pas kërkesës së kryeministrit ta shpërndajë parlamentin është njëra nga mjetet më të veçanta për vendosjen e baraspeshës ndërmjet bartësve të pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv.

2. Kompetencat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

Kushtetuta e RM-së numëron më shumë funksione që janë në kompetencë të Kuvendit të RM-së. Ato mund t'i klasifikojmë në disa grupe.

1. *Ligjvënia (kompetenca normative ose ligjvënëse)* është kompetencë tradicionale e parlamentit. Me këtë kompetencë nënkuptohet e drejta e parlamentit të sjellë ligje me të cilat në mënyrë burimore do t'i rregullojë marrëdhëniet shoqërore. Në kuadër të të kuptuarit më të gjerë të kësaj kompetence është e drejta e parlamentit të sjellë jo vetëm ligje, por të sjellë edhe Kushtetutën (pushteti kushtetutëbërës) dhe akte të tjera që janë lënë në kompetencën e tij. E drejta e parlamentit ta krijojë të drejtën (ta sjellë kushtetutën dhe ligjet) nuk do të thotë që parlamenti është bartës i sovranitetit dhe është mbi ligjin. Me gjithë se parlamenti formalisht e sjell kushtetutën, ai në punën e tij patjetër t'u nënshtrohet normave kushtetuese dhe mund të lëvizë vetëm brenda kuadrit normativ.

Sipas Kushtetutës së RM-së, Kuvendi i RM-së, në kuadër të kompetencës normative, sjell aktet në vijim:

- *Kushtetutën e RM-së;*
- *Ligje;*
- *Buxhetin Republikan dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;*
- *Planin hapësinor të Republikës.*

Në kuadër të kompetencës normative të Kuvendit bie edhe e drejta e tij për të dhënë komente autentike të ligjeve, si dhe e drejta për të ratifikuar kontratat ndërkombëtare. Kur kontratat ndërkombëtare, të lidhura nga pushteti ekzekutiv, do të vijnë para Kuvendit për ratifikim, kjo bëhet në formë të ligjit për ratifikim të kontratës ndërkombëtare. Kontrata ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e së drejtës së brendshme e RM-së.

2. Vendos për çështje të veçanta për sovranitetin e shtetit:

- *Vendos për luftë dhe paqe.* Kjo është çështje të veçanta për sovranitetin e shtetit. Megjithëse pushteti ekzekutiv është faktor dominues në udhëheqjen e politikës së

jashtme, çështja thelbësore për luftë dhe paqe është lenë në kompetencën e parlamentit pothuajse në të gjitha vendet, për shkak se lufta kërkon rregullimin e situatave të reja pothuajse në të gjitha fushat e jetës shoqërore, kërkon përcaktimin e shpenzimeve publike të reja, përcaktimin e detyrimit ushtarak dhe të ngjashme;

- *Shpall luftë dhe gjendjen e jashtëzakonshme;*
- *Sjell vendim për ndryshimin e kufirit të Republikës;*
- *Vendos për hyrjen dhe daljen nga bashkimi ose bashkësia me shtete të tjera.*

3. Funkzioni zgjedhor. Kuvendi i RM-së vendos për zgjedhjen e anëtarëve të organeve shtetërore të caktuara dhe emëron bartës në funksione të caktuara. Kështu, në kuadër të funksionit të tij, Kuvendi i RM-së:

- zgjedh Qeverinë e RM-së;
- zgjedh gjyqtarët e Gjykatës kushtetuese;
- zgjedh gjyqtarë;
- zgjedh anëtarët e komitetit për marrëdhënie në mes të bashkësive;
- zgjedh anëtarët e Këshillit gjyqësor Republikan;
- zgjedh avokatin e popullit;
- emëron Prokurorin publik;
- bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe të tjera të vërtetuara me Kushtetutë dhe me ligj.

4. Kontrolli politik dhe mbikqyrja e Qeverisë dhe e bartësve të tjerë të funksioneve publike që janë përgjegjës para Kuvendit. Kuvendi i RM-së zgjedh Qeverinë, kryen mbikqyrje të vazhdueshme mbi veprimtarinë e saj dhe e shkarkon atë. Kontrolli i Kuvendit, mbi veprimtarinë e Qeverisë, ushtrohet nga shumë mjete. Mjeti më efikas i kontrollit është e drejta e Kuvendit për të miratuar buxhetin, kjo është “ forca mbi kuletën ”. Nëpërmjet të përcaktimit të mjeteve që i lihen në disponim Qeverisë për vitin e ardhshëm, Kuvendi ushtron kontroll mbi veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv, për arsye se Qeveria nuk mund të punojë pa mjete financiare. Por, nga ana tjetër Qeveria është ajo që e përpunon dhe e propozon buxhetin të cilin e sjell Kuvendi, Qeveria është e ashtuquajtura “ propozues i atozuar ” i këtij ligji të komplikuar financiar.

Mjete të tjera të kontrollit të Kuvendit mbi veprimtarinë e Qeverisë janë: pyetjet e përfaqësuesve, interpelanca dhe çështja e (mos) besimit të Qeverisë.

Pyetjet e përfaqësuesve janë pyetje konkrete që deputetët ua parashtrojnë anëtarëve të Qeverisë me shkrim ose në formë gojore. Pyetje të përfaqësuesit mund të parashtrojë çdo deputet. Përgjigjja e pyetjes së përfaqësuesit jepet me gojë ose me shkrim, në seancën që ajo është parashtruar ose në ndonjë seancë të ardhshme.

Interpelanca është institut kontrolli që mund të parashtrohet për veprimtarinë e çdo bartësi të funksionit publik, Qeverisë dhe çdo anëtar të saj individualisht, si dhe për çështjet nga veprimtaria e organeve shtetërore. Interpelancë mund të paraqesin më së paku 5 deputetë. Interpelanca parashtrohet me shkrim dhe i drejtohet Qeverisë ose

bartësit të funksionit publik për punën e të cilit ka të bëjë interpelanca. Pas marrjes së përgjigjes së interpelancës, hapet *debati* në Kuvend që përfundon me *votim* që shpreh kënaqësinë ose paknaqësinë e Kuvendit me sqarimet të marra nga bartësi i funksionit publik ose Qeverisë. Mungesa e një kënaqësie të tillë mund të shërbejë si shkak për ngritjen e përgjegjesisë politike ose dorëheqjen e Qeverisë ose bartësit të funksionit publik. Vetvetiu interpelanca nuk sjell pasoja juridike për bartësin e funksionit publik ose për Qeverinë. Për shembull, në qoftë se deputetët nuk janë të kënaqur me përgjigjen e marrë nga ministri, për punën e të cilit është ngritur interpelanca, dhe këtë e shprehin gjatë votimit, interpelanca mund të shkaktojë vetëm pasoja morale, që do të thotë ose ministri mund vetë të japë dorëheqje ose kryetari i Qeverisë mund t'i propozojë Kuvendit shkarkimin e tij nga funksioni i ministrit.

Dallimi ndërmjet pyetjes së përfaqësuesit dhe interpelancës është:

- pyetja e përfaqësuesit mund të parashtrohet edhe *gojarisht edhe me shkrim*; interpelanca vetëm *me shkrim*;
- pyetje të përfaqësuesit mund të parashtrojë *çdo deputet*; interpelancë mund të parashtrojnë *më së paku 5 deputetë*;
- pas pyetjes së përfaqësuesit dhe përgjigjes pas kësaj pyetjeje nuk ka diskutim; pas interpelancës dhe përgjigjes së marrë hapet debati;
- Deputetët nuk e shprehin (pa) kënaqësin e tyre, nga përgjigja e marrë nga pyetja e përfaqësuesit me *votim*; Pas përfundimit të debatit mbi interpelancën në Kuvend votohet, nëpërmjet së cilës deputetët shprehen nëse janë të kënaqur nga përgjigja e marrë.

Si një nga mjetet më efikase të kontrollit politik të Kuvendit mbi Qeverinë është edhe mundësia që Kuvendi ta *shkarkojë Qeverinë*, ta *votojë mosbesimin e Qeverisë*. Në këtë çështje më vonë do të ndalemi më detajisht.

5. *Të ashtuquajturat funksione gjyqësore*. Në kuadër të këtyre funksioneve të Kuvendit është e drejta e Kuvendit për të dhënë *amnistia*. Amnistia silltet në formë ligji me të cilin një numër i *pacaktuar personash* lirohen nga ndjekja, plotësisht ose pjesërisht lirohen nga ekzekutimi i dënimeve, atyre u zëvendësohet dënimi i shqiptuar në më të butë, vërtetohet fshirja e dënimit ose dërpriten pasojat juridike nga ky dënim, gjatë së cilës nuk preket plotëfuqishmëria e aktgjykimit, ose ekzistimi i veprës penale.

6. Në kompetencë të Kuvendit të RM-së është të *shpallë referendum*. Referendumi është formë e shprehjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve, nëpërmjet referendumit qytetarët drejtpërdrejtë marrin pjesë në jetën politike të vendit.

7. Përveç autorizimeve të përmendura Kuvendi i RM-së *vendos edhe për rezervat e Republikës dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë*.

Përveç autorizimit që të sjellë Kushtetutë dhe ligje, për kryerjen e veprimtarive në kompetencën e tij, Kuvendi ka të drejtë të sjell edhe akte të tjera, siç janë: vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe përfundime.

3. Struktura organizative e Kuvendit

Çështja e strukturës organizative e kuvendit në vete përfshin tri çështje: çështja e punës së Kuvendit; çështja e trupave (komisioneve) punuese dhe funksionarët e Kuvendit; dhe çështja e pozitës së deputetëve.

3.1. Parimet e punës së Kuvendit

Sipas kushtetutës së RM-së Kuvendi rregullisht mban seanca. Kuvendi i RM-së është trup përfaqësues njëdhomësh që punon në seanca.

Seancat e Kuvendit i thërret kryetari i Kuvendit.

Sipas amendamentit X të vitit 2001 Kuvendi mund të vendosë nëse në seancë merr pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve (*shumica absolute*). Në përbërjen e tanishme të Kuvendit shumicë absolute përbëjnë 61 deputetë ($120 : 2 + 1 = 60 + 1 = 61$). Me këtë amendament u zëvendësua dispozita nga neni 68 sipas së cilës Kuvendi mund të punojë nëse në seancë marrin pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Ndryshimi i kësaj dispozite ishte i motivuar nga pamundësia e shpeshtë e Kuvendit për të siguruar kuorum për të debatuar për çështje të caktuara. Kështu që me këtë amendament u hoq nevoja e pjesmarrëjes së 61 deputetëve në mënyrë që Kuvendi të mundë të debatojë për çështje të caktuara, ndërsa u parapa kuorumi i nevojshëm vetëm që Kuvendi të mund të vendosë. Kjo nuk do të thotë që Kuvendi të gjitha vendimet i miraton më së paku me shumicë absolute (61 deputet), por më së paku aq deputet duhet të marrin pjesë në seancë që Kuvendi të mund të vendos.

Kuvendi vendos me shumicë votash nga numri i deputetëve të pranishëm (*shumicë votash*), kurse më së paku me një të tretat nga numri i përgjithshëm, nëse me Kushtetutë nuk është parashikuar shumicë e veçantë.

Seancat e Kuvendit janë publike, por Kuvendi mund të vendosë që të punojë pa prezencën e publikut me shumicë votash prej dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (*shumicë e cilësuar*).

3.2. Trupat punuese dhe funksionarët e Kuvendit

3.2.1. Trupat punuese të kuvendit

Kuvendi themelon trupa punuese të përhershme dhe të përkohshme. Trupat punuese I ndihmojnë Kuvendit dhe kontribuojnë për një punë më efikase të tij. Në seancat e trupave punuese shqyrtohen çështjet dhe përgatiten propozime për marrjen e vendimeve në seancën (plenare) e Kuvendit. Trupat e përhershme punuese ekzistojnë gjatë gjithë mandatit të Kuvendit. Trupat e përkohshme punuese formohen për aktivitet të caktuar dhe pas përfundimit të tij pushojnë së ekzistuari.

Kuvendi mund të themelojë edhe *komisione anketuese* për të gjitha fushat dhe për çdo çështje me interes publik. Propozimin për themelimin e komisionit anketues mund ta japin më së paku 20 deputetë. Komisionet anketuese i analizojnë çështjet për të cilat janë formuar. Mendimet e komisioneve anketuese janë bazë për fillimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike. Kuvendi themelon *komision të përhershëm anketues për liritë dhe të drejtat e qytetarit*.

3.2.2. Funkionarët e Kuvendit

Funkionarët e Kuvendit të zgjedhur nga radhët e deputetëve janë kryetari i Kuvendit dhe nënkryetarët e Kuvendit. Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumicë absolute), nga radhët e deputetëve zgjedh kryetarin dhe më së shumti dy nënkryetarë.

Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, kujdeset për zbatimin e Rregullores së Kuvendit dhe ushtron veprimtari të tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Funksioni i Kryetarit të Kuvendit është i papajtueshëm (*inkompatibil*) me kryerjen e ndonjë *funksioni tjetër publik, profesioni ose funksioni në parti politike*.

Nënkryetarët e Kuvendit i ndihmojnë në punë Kryetarit të Kuvendit dhe në marrëveshje me të kryejnë punë të caktuara nga fushëveprimi i tij.

3.3. Pozita e deputetëve

Pozita e deputetëve në kuvend duhet të jetë e atillë në mënyrë që ato të mund të ushtrojnë funksionin e tyre dhe tu sigurohet pavarësi nga presione të jashtme, si dhe pavarësi të funksionit të deputetit si i tillë. Në këtë drejtim, janë të veçanta dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën e imunitetit të deputetëve; dispozitat për inkompatibilitetin e funksionit të deputetit dhe dispozitat për kompensim material.

3.3.1. Imuniteti

Deputetët gëzojnë *imunitet thelbësor, material dhe imunitet procedural*.

Imuniteti material konsiston në papërgjegjësinë e deputetit për mendimin e shprehur dhe për votimin në Kuvend, deputeti nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose të burgoset për mendimin e shprehur ose për votimin në Kuvend. Ky imunitet i mundëson deputetit që lirisht ta ushtrojë funksionin e deputetit pa u kërcënuar nga ndjekja penale. Nëpërmjet tij deputetit i garantohet liri e pakufizuar, absolute e shprehjes në Kuvend. Ky imunitet e mbron deputetin nga ndjekja penale për mendimin e shprehur dhe votimin në Kuvend. Për shprehjen e mendimit jashtë Kuvendit deputetët përgjigjen si gjithë njerëzit e tjerë në RM-së. Ky imunitet i deputetëve vlen për kohën e mandatit dhe pas mbarimit të mandatit të tyre.

Imuniteti procedural e mbron deputetin nga arresti. Me fjalë të tjera, deputeti nuk mund të arrestohet pa miratimin e Kuvendit, përveç nëse është kapur në kryerjen e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg më së paku pesë vjet. Kuvendi mund të vendosë që imuniteti të zbatohet mbi deputetin edhe kur ai vetë nuk është thirrur në të, nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e funksionit të deputetit.

Dispozitat për imunitetin e deputetëve në Kushtetutën e RM-së janë plotësuar edhe me lirim të deputetëve nga detyrimi i pjesëmarrjes në forcat e armatosura për sa kohë zgjat mandati.

3.3.2. Inkopatibiliteti

Kushtetuta e RM-së parasheh që me ligj të përcaktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me kryerjen e profesioneve ose funksioneve të tjera publike. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë² për herë të parë e fut dispozitën se funksioni i deputetit kryhet në mënyrë profesionale. Dispozita për kryerjen në mënyrë profesionale të funksionit të deputetit është përmbledhur edhe në ligjin për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë³. Arsyet për inkopatibilitet dhe profesionalizëm në funksionin e deputetit janë që të sigurohet pavarësia e funksionit të deputetit kundrejt faktorëve të tjerë dhe qasje më serioze të deputetit ndaj obligimeve përfaqësuese të tij.

3.3.3. Kompensimi material

Kushtetuta e RM-së edhe të drejtën e deputetëve për kompensim të parashikuar me ligj. Qëllimi i të drejtës së deputetëve për kompensim është që kjo të shërbejë si mjet për ndalimin e korrupsionit, nga njëra anë, si dhe mundësia që funksioni i deputetit të jetë i pranishëm jo vetëm në poret e larta të shoqërisë por edhe në kategoritë e tjera sociale.

4. Procedura për sjelljen e ligjeve dhe të akteve të tjera të Kuvendit

Procedura për sjelljen e ligjeve dhe akteve të tjera në Kuvend është e harmonizuar dhe kalon disa faza.

Iniciativë për sjelljen e ligjit mund të ngrejë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata. Ato iniciativën e tyre ua shpallin propozuesve të autorizuar.

Propozuesit e autorizuar janë: çdo deputet i Kuvendit, Qeveria e RM-së dhe më së paku 10.000 zgjedhës. Ato kanë të drejtë të propozojnë sjelljen e ligjit. *Propozimin për sjelljen e ligjit*, të cilin e dorëzojnë propozuesit e autorizuar, duhet të ketë bazë kushtetuese për sjelljen e ligjit, arsyet e sjelljes së ligjit, parimet themelore mbi të cilat

² "Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 50/99.

³ "Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 42/2002.

duhet bazuar ligji dhe nevojën e sigurimit të mjeteve për realizimin e ligjit. Propozimi i sjelljes së ligjit duhet të përfshijë edhe arsyetimin.

Propozimi për sjelljen e ligjit i dorëzohet kryetarit të Kuvendit, i cili ua dorëzon deputetëve. Më shpesh si propozues i ligjeve në RM-së paraqitet Qeveria e RM-së. Në rastin kur ajo nuk është propozuese e ligjit, propozimi për sjelljen e ligjit dorëzohet edhe në Qeveri për arsye të marrjes së mendimit.

Propozimi për sjelljen e ligjit shqyrtohet nga trupi punues kompetent (komisioni) në domenin e të cilit është materia që duhet të rregullohet me ligj, si dhe nga komisioni Juridiko-legjislativ i cili jep mendim për nevojën e sjelljes së ligjit dhe pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën. Në qoftë se sjellja e ligjit kërkon angazhimin e mjeteve financiare, atëherë propozimi futet në rend dite edhe në seancën e trupit punues në kompetencën e të cilit janë çështjet për buxhetin dhe financat.

Kur propozimi për sjelljen e ligjit do të shqyrtohet në seancat e këtyre trupave punuese, futet në rend dite në seancën e Kuvendit, i cili në se vendos se ligji duhet sjellë, sjell përfundim për miratimin e propozimit për sjelljen e ligjit dhe e ngarkon propozuesin që të përpunoj *propozimligjin*, përkatësisht nëse bëhet fjalë për ligj që rregullon çështje sistemore ose materie voluminoze, të përpunojë *projektligj*. Në qoftë se nuk bëhet fjalë për ligj të harmonizuar dhe voluminoz, propozuesi mund që bashkë me propozimin për sjelljen e ligjit ta dorëzoj edhe projek ligjin dhe të propozojë që ai të shqyrtohet në të njëjtën seancë në të cilën do të shqyrtohet dhe propozimi për sjelljen e ligjit.

Në qoftë se Kuvendi ka vendosur që ta ngarkojë propozuesin për ta përpunuar projektligjin, ai përpunohet në formën që janë përpunuar ligjet dhe patjetër duhet të arsyetohet. Projektligji debatohet në seancat e trupave punuese kompetente të Kuvendit dhe futet në rend dite në seancën e Kuvendit. Diskutimi mbi projektligjin në seancë të Kuvendit është i vetëm. Në diskutim shprehen mendimet në se parimet e caktuara mbi të cilat është bazuar ligji janë zbatuar drejt dhe përfundimisht në projektligj dhe a janë përfshirë marrëdhëniet bazë që duhen rregulluar si dhe mënyra mbi të cilën propozohet rregullimi i tyre. Pas përfundimit të diskutimit mbi projektin, qëndrimet dhe vërejtjet me përfundim drejtohen deri tek propozuesi me qëllim që ai t'i ketë parasysh gjatë përgaditjes së projektligjit.

Kuvendi mund të vendosë të shpallë diskutim publik mbi projektligjin i cili është me interes më të gjerë. Në këtë rast projektligji, bashkë me thirjen për dorëzimin e mendimeve, propozimeve dhe afatin në të cilin kjo mund të bëhet, shpallet në shtypin ditor që do ta caktojë Kuvendi. Mbi bazën e mendimeve dhe propozimeve të shprehura në diskutimin publik, propozuesi i ligjit paraqet projektligjin.

Propozimligji paraqitet në formën në të cilën sillet ligji dhe kalon të njëjtën procedurë në trupat punuese si dhe propozimi për sjelljen e ligjit. Kur do të vijë në rend dite në seancën e Kuvendit, gjatë diskutimit deputetët, Qeveria dhe 10.000 zgjedhës kanë mundësi të propozojnë amendamente për propozimligjin. Për

amendamentet zhvillohet diskutim i veçantë. Për nevojën e pranimit ose të refuzimit të amendamenteve shprehet propozuesi, ndërsa Qeveria e ka këtë të drejtë edhe atëherë kur nuk është propozues i ligjit. Në qoftë se propozuesi pajtohet për ndonjë amendament, ai bëhet pjesë përbërëse e propozimit. Për amendamentet vendoset para se të votohet dispozita për të cilën ka të bëjë amendamenti. Për amendamentet që janë paraqitur për të njejtën dispozitë votohet sipas radhës së paraqitjes së tyre. Në qoftë se ndonjë amendament propozon fshirjen e ndonjë dispozite, pikë së pari votohet për atë amendament dhe nëse ai miratohet, amendamentet e tjera të kësaj dispozite nuk shqyrtohen. Nëse amendamenti i propozimligjit përmban rregulla me të cilat ndryshohen parimet e përcaktuara mbi të cilën bazohet ligji ose nëse miratimi i amendamentit do të shkaktojë ndryshime qënësore të tekstit të propozim ligjit, për amendamentin nuk mund të vendoset në seancën e Kuvendit në qoftë se trupi punues kompetent dhe komisioni legjislativo-juridik nuk e kanë shqyrtuar dhe nuk kanë dhënë raport për atë amendament. Në qoftë se përsëri amendamenti përmba dispozita me të cilat angazhohen mjete financiare, kryetari i Kuvendit menjëherë ia dorëzon edhe trupit punues në fushëveprimin e të cilit bien çështjet e buxhetit dhe të financave.

Ligjet miratohen me votimin e deputetëve. Në varësi të shumicës së nevojshme për sjelljen e ndonjë ligji, dallohen *ligjet e thjeshta* dhe ato *organike*. Për sjelljen e ligjeve organike është e nevojshme shumicë e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve (shumica e cilësuar). Ligje të këtilla për miratimin e të cilëve Kushtetuta kërkon shumicë të cilësuar, janë : Ligjet për stemën, flamurin dhe himnin e RM-së; ligji për llojet, kompetencën, themelimin, anulimin, organizimin dhe përbërjen e gjykatave; ligjet për procedurën para gjykatave; ligji për organizimin dhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore; ligji për vetqeverisjen lokale; ligji për mbrojtje. Tek ligjet e thjeshta bëhet dallimi ndërmjet ligjeve që miratohen me shumicë absolute dhe ligjeve që miratohen me shumicë relative.

Amendamenti X i vitit 2001 parasheh shumicë të veçantë për sjelljen e ligjeve që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve. Për miratimin e tyre Kuvendi vendos me shumicë votash nga numri i pranishëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga deputetët e pranishëm që u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Pas miratimit të ligjit, ai drejtohet te Presidenti i shtetit për ta shpallur me dekret. Dekretin e shpalljes së ligjit e firmos Kryetari i Kuvendit dhe Presidenti i Republikës, me ç'rast Presidenti i Republikës mund t'i vë veto. Do të thotë, shefi i shtetit mund të vendosë që mos ta firmos dekretin për shpalljen e ligjit, ndërsa kryetari i Kuvendit nuk e ka mundësinë e zgjedhjes, ai patjetër duhet ta firmosë të njëjtin. Në qoftë se Presidenti i Republikës vendosë që mos ta firmosë dekretin për shpalljen e ligjit, ligji kthehet në Kuvend për rishikim dhe në se Kuvendi e miraton ligjin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumicë absolute), Presidenti i Republikës është i detyruar ta firmos dekretin për shpalljen e ligjit. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtën e vetos për ligjet që sipas Kushtetutës së RM-së miratohen me shumicë të dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumicë e cilësuar).

Pas firmosjes së dekretit për shpalljen e ligjit, ligji shpallet në “ Gazetën zyrtare të RM-së ”. Ligji hyn në fuqi më së shpejti ditën e tetë nga dita e shpalljes. Kjo periudhë nga shpallja e ligjit dhe deri në hyrjen e tij në fuqi quhet *vacatio legis* dhe lihet me qëllim të njohjes së publikut me të. Me përjashtim, që e vërteton Kuvendi, ligji mund të hyjë në fuqi në ditën e shpalljes.

Në raste të caktuara, në qoftë se bëhet fjalë për ligj të komplikuar, ligji mund të sillet me *procedur të shkurtuar*. Propozimin për sjelljen e ligjit sipas procedurës së shkurtuar mund ta paraqesë propozuesi i autorizuar, kryetari i Kuvendit, trupi punues i Kuvendit dhe Qeveria.

Me përjashtim, ligji mund të sillet edhe sipas *procedurës së përshpejtuar* . Kjo ndodh kur është e domosdoshme për pengimin e shkatërrimit të ekonomisë, kur është në pyetje mbrojtja dhe siguria e vendit, fatëkeqësitë e mëdha ose nevoja të tjera të jashtëzakonshme. Propozuesi kundrejt propozimit për sjelljen e ligjit duhet të paraqesë edhe projektligjin, si dhe të arsyetojë nevojën e zbatimit të procedurës së përshpejtuar. Në qoftë se propozimi për sjelljen e ligjit sipas procedurës së përshpejtuar miratohet, atëher propozim ligji vendoset në rend dite në të njëjtën seancë.